




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN

VENDIM

Nr.15, datë 08.06.2023



PËR  
**RINOVIMIN E LEJES NR.46 DATË 16.10.2017 MIRATUAR ME  
VENDIMIN NR.54/2 PROT., DATË 10.10.2017 “PËR PËRDORIM  
BURIMI UJOR KURATIV, MINERAL, TERMOMINERAL DHE  
GJEOTERMAL (LLIXHA),  
SUBJEKTIT “GJERGJI LIÇI”**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes nr.46 datë 16.10.2017 miratuar me vendimin nr.54/2, datë 10.10.2017 të Këshillit të Basenit Ujqor Shkumbin për “Përdorim burimi ujqor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal (Ilixha)” subjektit “Gjergji Liçi” me Adresë Njësia Administrative Tregan Elbasan Qarku Elbasan.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për burimin sipas KRGJSH



X= 506086 ; Y= 4544255 ; Z= 144 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- X= 506063 ; Y= 4544555 ; Z= 134 m.m.n.d
- Sasia e ujit që jepet në përdorim:  $Q=0.0003 \text{ m}^3/\text{s}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

**MAJLINDA PERRIU**

